

ANKETA TREMUJORE E FORCAVE TË PUNËS

Tremujori II 2026

Ky njoftim për media paraqet tregues kryesor tremujor mbi pjesëmarrjen në forcat e punës, punësimin dhe papunësinë bazuar në Anketën Tremujore të Forcave të Punës (ATFP).

Pjesëmarrja në forcat e punës

Në tremujorin e dytë të vitit 2026, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç është 76,3 %.

- Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2025, ky tregues është rritur me 0,1 pikë përqindje;
- Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është rritur me 0,1 pikë përqindje.

Punësimi

Në tremujorin e dytë të vitit 2026, shkalla e punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart është 58,3 %.


- Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2025, ky tregues është ulur me 0,1 pikë përqindje;
- Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është rritur me 0,3 pikë përqindje.

Papunësia


Në tremujorin e dytë të vitit 2026, shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart është 8,3 %.

- Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2025, ky tregues është ulur me 0,2 pikë përqindje;
- Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është ulur me 0,1 pikë përqindje.

FIG. 1 NDRYSHIMI VJETOR DHE TREMUJOR I PUNËSIMIT SIPAS GRUP AKTIVITETEVE



Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës

FIG. 2 TREGUESIT E TREGUT TË PUNËS SIPAS GRUPMOSHËS DHE GJINISË**Shënim për përdoruesit:**

- Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Anketa Tremujore e Forcave të Punës](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtitimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor pranë familjeve, i cili synon të sigurojë informacion të rregullt dhe të krahasueshëm mbi tregun e punës në Shqipëri. Të dhënat e saj përdoren për monitorimin e zhvillimeve në tregun e punës dhe për hartimin e politikave ekonomike e sociale.

ATFP zbatohet në përputhje me metodologjinë dhe përkufizimet e përcaktuara nga International Labour Organization dhe Eurostat, duke siguruar krahasueshmëri të treguesve të tregut të punës me vendet e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare. Treguesit kryesorë, si punësimi, papunësia, pjesëmarrja në forcat e punës dhe inaktiviteti ekonomik, llogariten sipas koncepteve dhe kriterëve të harmonizuara të ILO-s dhe Eurostat-it.

Për tremujorin e dytë të vitit 2026, kampioni i anketës bazohet në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe përbëhet nga 7.900 familje. Kampioni përzgjidhet sipas një procedure me dy faza: në fazën e parë zgjidhen njësitë gjeografike të kampionimit me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e tyre, ndërsa në fazën e dytë përzgjidhet një numër fiks familjesh brenda secilës njësi me probabilitet të barabartë. Kjo metodë siguron përfaqësueshmërinë e rezultateve në nivel kombëtar dhe rajonal.

Anketa ka një strukturë paneli, ku familjet intervistohen për pesë tremujorë radhazi, me periudhë intervistimi pas çdo 13 javësh. Të dhënat mbledhen përmes intervistave direkte me anëtarët e familjeve që janë mbi 15 vjeç. Shkalla e përgjigjes për tremujorin e dytë 2026 ishte 83.9 %. Për përgjithësimin e të dhënave, përdoren të dhënat nga Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe ngjarjet demografike të regjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Përkufizime

Popullsia në moshë pune konsiderohen të gjithë personat 15-64 vjeç.

Të punësuar konsiderohen personat që kanë punuar, madje dhe për një orë, gjatë javës së referencës, përfshirë ata që marrin trajnim të paguar ose kanë munguar përkohësisht (për arsye si leje lindje, sëmundje, etj.).

Të papunë konsiderohen personat që ishin pa punë gjatë javës së referencës, janë të gatshëm për punë dhe po kërkojnë punë aktivisht.

Forca e punës përfshin të punësuarit dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive konsiderohen personat që nuk janë të punësuar apo të papunë (si nxënës, pensionistë, të paafët).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune. Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve ndaj forcës së punës. Shkalla e pjesëmarrjes është raporti i forcës së punës ndaj popullsisë në moshë pune.

Notë shpjeguese mbi treguesit kryesorë të tregut të punës

Treguesit e tregut të punës për shkallën e punësimit dhe pjesëmarrjes në forcën e punës llogariten për popullsinë 15-64 vjeç, duke qenë më të saktë dhe kuptimplotë.

Shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomisht aktive (15 vjeç e lart), dhe nuk ndikohet nga personat në pension. Përfshirja e pensionistëve në shkallët e punësimit dhe pjesëmarrjes mund të ulë saktësinë e rezultateve, ndërsa shkalla e papunësisë pasqyron vetëm individët aktivë në kërkim të punës.

Cilësia e statistikave të tregut të punës

Rezultatet e Anketës së Forcave të Punës të paraqitura në këtë njoftim për media janë kalibruar, duke përdorur popullsinë rezidente sipas rezultateve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Treguesit kryesorë të tregut të punës vlerësohen nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Anketa është bazuar në një zgjedhje probabilitare prej 7.900 njësisë ekonomike familjare. Zgjedhja e njësisë ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë vlerësime sa më të sakta për treguesit kryesorë të tregut të punës. Pra, nga anketa mund të sigurohen vlerësime dhe jo shifra ekzakte për numrin e të punësuarve dhe të papunëve. Për çdo vlerësim që merret nga anketa llogaritet varianca e zgjedhjes për të treguar se si do të ndryshonte vlerësimi nëse do të kryeshin zgjedhje të ndryshme të rastit me të njëjtin vëllim për të njëjtën periudhë, në vend të një zgjedhjeje të vetme. Kjo na lejon që të përcaktojmë kufijtë brenda të cilëve duhet të gjendet vlerësimi (që në terminologjinë statistikore njihet si intervali i besimit).

Në përgjithësi, sa më e vogël të jetë vlera e devijimit standard relativ të një vlerësimi aq më i lartë është niveli i saktësisë së vlerësimit. Në tabelën 1, paraqiten devijimi standard relativ dhe intervali i besimit për treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë 15 vjeç e lart.

TAB. 1 DEVIJIMET STANDARDE TË PËRGJITHSHME TË ZGJEDHJES PËR TREGUESIT E TREGUT TË PUNËS

Indikatori	Numri personave në punësim (15+)	Shkalla e punësimit (%)	Numri personave të papunë (15+)	Shkalla e papunësisë (%)
Vlerësimi	1.159.556	58,3%	104.616	8,3%
SE	23.841	0,7%	7.229	0,6%
CV	2.06	1.18	6.91	6.82
CI- Lower	1.112.756	57%	90.425	7,2%
CI-Upper	1.206.355	59,7%	118.808	9,5%

(*) për nivelin e besueshmërisë 95 %

Shkalla e papunësisë për popullsinë e moshës 15+ vjeç vlerësohet 8,3 %, me një devijim standard prej 0,6 %. Për një nivel besueshmërie 95 %, intervali i besueshmërisë për këtë tregues varion nga 7,2 % deri në 9,5 %, kjo tregon se me 95 % besueshmëri, vlera reale e shkallës së papunësisë është brenda këtij intervali.

Ndërkohë, përqindja e popullsisë 15+ vjeç që është në punësim vlerësohet 58,3 %, me një devijim standard prej 0,7 %. Për një nivel besueshmërie 95 %, intervali i besueshmërisë për këtë tregues varion nga 57 % deri në 59,7 %, kjo tregon se vlera reale e shkallës së punësimit në popullsi është brenda këtij intervali.